



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1286/4 Prot.,

Datë 13.07.2022

V E N D I M

Nr. 663/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-32392-06-09-2022, me objekt “Sistemi i monitorimit me kamera të qytetit” me fond limit 8,214,311 (tetë milionë e dyqind e katërbëdhjetë mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Ankimues:

“Impact” SHPK
Rruga “Komuna e Parisit”, Pallati nr. 4, Dyqani nr. 2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Vlorë
Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga:”Osman Haxhiu”

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë
19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të
prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të
Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018
“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe
funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,
Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit
Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për
Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e
Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të
Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së
shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.06.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-32392-06-09-2022, me objekt “Sistemi i monitorimit me kamera të qytetit” me fond limit 8,214,311 (tetë milionë e dyqind e katërbëdhjetë mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 16.06.2022 operatori ekonomik “Impact” SHPK, ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesve.

II.4. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 11286/2 prot., datë 23.06.2022 i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Impact” SHPK, në përputhje me përcaktimet e nenit 114 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 6894/2 prot., datë 24.06.2022 protokolluar me tonën me nr. 1286/3 prot., datë 01.07.2022 me objekt “*Informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankësën e operatorit ekonomik ankimues dhe me shkresën nr. 6894/2 prot., datë 24.06.2022, ka vendosur mospranimin të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Impact” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit (specifikimet teknike) të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, me argumentin: “Autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë ka shpallur dokumentacionit të tenderit në tenderin me objekt: “Sistemi i monitorimit me kamera të qytetit”, në portalin online e.ee.app.gov.al më datë 10.06.2022. Kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë rezulton se në seksionin e specifikimeve teknike për produktin Kamera e Jashtme ANPR, Tipi i kamerës (“Type of camera”)- Bullet PTZ RROTULLIM 360 Grade, Rezolucioni i figurës (“Resolution”)-2592 X 1944, Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”)- minimumi 30 fps at 5MP, Ndricimi minimal (“Min Illumination”)- Color: 0.0005 lux, Gjatësia fokale (“Focal length”)- 5-117mm, si dhe kriteri Funkcionalitete te tjera- License Plate Recognition, Plate Type Classification, Plate Color Recognition, Vehicle Type Classification, Vehicle Color Recognition, Vehicle Direction Detection (minimum 4 regions), i vendosur është një kombinim i kriterëve të cilat të orientojnë te i vetmi prodhues i cili është MILESIGHT, kriter tërësisht diskriminues i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë zvogëlon konkurrencën e hapur të operatorëve ekonomikë.

2.6 Kamera e Jashtme ANPR (Lexues Targe Makine)

Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Tipi i kamerës (“Type of camera”)	Bullet PTZ RROTULLIM 360 Grade
Procesori i figurës (“Image Sensor”)	Progressive Scan CMOS sensor 1/2.8”
Rezolucioni i figurës (“Resolution”)	2592 X 1944
Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”)	minimumi 30 fps at 5MP
Ndricimi minimal (“Min Illumination”)	Color: 0.0005 lux
Tipi i lenteve (“Lens Type”)	E ndryshueshme (Motorized Varifocal)
Gjatësia fokale (“Focal length”)	5-117mm
Ndriçimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”)	Po; min 180 m;
Rezistenca	IP67 , IK10
Diapazoni dinamik i djeshmërisë, (Ëide Dynamic range)	Po (“Yes) , 120dB
Formati i kompresimit të Videos	H.265 ose me mire
Dedektim i lëvizjes (“Motion Detection”);	Po (“Yes”)
Funksionalitete te tjera	License Plate Recognition, Plate Type Classification, Plate Color Recognition, Vehicle Type Classification, Vehicle Color Recognition, Vehicle Direction Detection (minimum 4 regions)
Permiresim te imazhit	BLC/ HLC
Memorie Shtese SD Card	Po (Yes), minimum nga 256GB
Temperatura e operimit (“Operating Temperature”)	-40°C + 60°C
Ushqimi (“Poër”)	PoE, dhe 12VDC
Multi-streaming	Min.3 stream

Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:	1 Vit
---	--------------

Ju vëmë në dukje se specifikimet teknike në pikën 2.6 të evidentuara me të verdhë janë hartuar në kundërshtim të hapur me përcaktimet dhe frymen e ligjit dhe vendimit të këshillit të ministrave për këtë fushë, pasi këto kritere të kombinuara sëbashku janë hartuar në bazë të një modeli të caktuar MS-C5367-X23LPC të prodhuar nga kompania MILESIGHT si dhe të tregtuar ekskluzivisht dhe e bllokuar për këtë procedurë nga një kompani shqiptare, vërtetuar kjo nëpërmjet komunikimit zyrtar me email me kompaninë MILESIGHT. Sa më sipër, modeli i caktuar i cili të orienton në mënyrë të drejtëpërdrejtë të i vetmi produkt i cili tregtohet nga vetëm një kompani në Republikën e Shqipërisë si dhe bën njëkohësisht të pamundur ofrimin e produkteve nga 10 prodhues të tjerë me prestigjioz dhe më të mëdhenj në listën e publikuar nga kompania më e madhe e analizës së tregut security Asmag:www.asmag.com/rankings/ të cilët janë: Hikvision, Dahua, Axis, Motorola, Univieë, Tiandy, TKH Group, Hanëhan Techëin, Infinova, Streamax. Prodhues të cilët mbulojnë rreth 80% të volumit në tregun botëror). Për sa më sipër të gjithë elementët dhe provat që ne po paraqesim përbëjnë shkelle të barazisë dhe të konkurrencës së lirë për pjesëmarrje në prokurimet publike. Realizimi i plotë i funksionalitetit të kësaj pajisje realizohet në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse edhe nga produkte të tjera të ngjashme apo ekuivalente duke e bërë këtë kriter diskriminues dhe përjashtues për shumë operatorë ekonomikë dhe duke penguar konkurrencën e lirë. Në këto kushte kërkojmë ndryshimin e këtyre kritereve si më poshtë, duke e bërë këtë produkt të ofrueshëm nga disa operatorë ekonomikë dhe brande prestigjioze si dhe duke mos ndërhyrë njëkohësisht në funksionalitetin e tij.

Bëhet:

2.6 Kamera e Jashtme ANPR (Lexues Targe Makine)

Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Tipi i kamerës (“Type of camera”)	Bullet/DOME PTZ RROTULLIM 360 Grade
Procesori i figurës (“Image Sensor”)	Progressive Scan CMOS sensor 1/2.8”
Rezolucioni i figurës (“Resolution”)	2560 X 1440
Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”)	minimumi 30 fps at 4MP
Ndricimi minimal (“Min Illumination”)	Color: 0.0008 lux
Tipi i lenteve (“Lens Type”)	E ndryshueshme (Motorized Varifocal)
Gjatësia fokale (“Focal length”)	6-117mm
Ndricimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”)	Po; min 180 m;
Rezistenca	IP67 , IK10
Diapazoni dinamik i djeshmërisë, (Ëide Dynamic range)	Po (“Yes) , 120dB
Formati i kompresimit të Videos	H.265 ose me mire
Dedektim i lëvizjes (“Motion Detection”);	Po (“Yes”)
Funksionalitete te tjera	License Plate Recognition, Vehicle

	Color Recognition,
<i>Permiresim te imazhit</i>	<i>BLC/ HLC</i>
<i>Memorie Shtese SD Card</i>	<i>Po (Yes), minimum nga 256GB</i>
<i>Temperatura e operimit (“Operating Temperature”)</i>	<i>-40°C + 60°C</i>
<i>Ushqimi (“Poëer”)</i>	<i>PoE, dhe 12VDC</i>
<i>Multi-streaming</i>	<i>Min.3 stream</i>

Sa më sipër, në kushtet kur ky kriter është tërësisht diskriminues dhe cenon konkurrencën e hapur midis operatorëve ekonomikë në kundërshtim të hapur me dispozitat e parashikuara në LPP dhe VKM, kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri sipas përcaktimeve të mësipërme si dhe shtyrjen e datës së paraqitjes së ofertave ekonomike me 5 ditë., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, sipas dokumentacionit të paraqitur në SPE, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj: Jane hartuar sipas shtojces bashkelidhur se bashku me preventivin. Referuar udhezimeve te APP, per zerat ne DST qe mund te jete paraqitur marke/brand, operatoret ekonomik mund te ofertojne ekuivalente te tyre gjate pergatitjes se ofertes ekonomike.

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Relacioni dhe preventivi për kamera sigurie:

2.6 Kamera e Jashtme ANPR (Lexues Targe Makine)

Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Tipi i kamerës (“Type of camera”)	Bullet PTZ RROTULLIM 360 Grade
Procesori i figurës (“Image Sensor”)	Progressive Scan CMOS sensor 1/2.8”
Rezolucioni i figurës (“Resolution”)	2592 X 1944
Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”)	minimumi 30 fps at 5MP
Ndricimi minimal (“Min Illumination”)	Color: 0.0005 lux
Tipi i lenteve (“Lens Type”)	E ndryshueshme (Motorized Varifocal)
Gjatësia fokale (“Focal length”)	5-117mm
Ndriçimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”)	Po; min 180 m;
Rezistenca	IP67 , IK10
Diapazoni dinamik i djeshmërisë, (Ëide Dynamic range)	Po (“Yes) , 120dB
Formati i kompresimit të Videos	H.265 ose me mire
Dedektim i lëvizjes (“Motion Detection”);	Po (“Yes”)
Funksionalitete te tjera	License Plate Recognition, Plate Type Classification, Plate Color Recognition, Vehicle Type Classification, Vehicle Color Recognition, Vehicle Direction Detection (minimum 4 regions)
Permiresim te imazhit	BLC/ HLC
Memorie Shtese SD Card	Po (Yes), minimum nga 256GB
Temperatura e operimit (“Operating Temperature”)	-40°C + 60°C
Ushqimi (“Poër”)	PoE, dhe 12VDC
Multi-streaming	Min.3 stream
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:	1 Vit

III.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijcencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2.

Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.4. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

III.5. Neni 36 “Specifikimet teknike” i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e

punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”.

III.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim

është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në rastin konkret nga ana e ankimuesit kërkohet modifikim i specifikimeve teknike pika 2.6 *Kamera e Jashtme ANPR (Lexues Targe Makine)*. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP e konkretisht kthim-përgjigjes drejtuar ankimuesit, autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë nuk ka pranuar asnjë nga pretendimet e operatorit ekonomik “Impact” SHPK.

III.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike

ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*

Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për siguri të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "*specifikim teknik*" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 "Komisioni Europian vs. Mberëtëria e Hollandës" inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: "*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.*"

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" të parashtrajnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 "Për prokurimin publik" është përafshuar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike", e ndryshuar*". Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar". KPP thekson, se fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht *sine qua non*, se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuarit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në të cilin parashikohet se: "*në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*". Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti

kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet t'i përmbahet *stricto-sensu* vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik. Gjithashtu, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

III.8. Referuar dokumentacionit të administruar, Komisioni vëren, se për hartimin e specifikimeve teknike për pajisjen objekt-prokurimi, të cilat kundërshtohen nga operatori ekonomik ankimues “Impact” SHPK, autoriteti kontraktor është bazuar në shkronjën “a”, të pikës 3, të nenit 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, duke vlerësuar si të domosdoshme dhe të rëndësishme kapacitetet funksionale të pajisjes dhe performancën e saj. Në rastin konkret, bazuar në specifikat e veçanta të pajisjes objekt-prokurimi, si dhe bazuar në përdorimin kompleks të kësaj pajisjeje, Komisioni gjykon se për autoritetin kontraktor është tepër rëndësishme që të prokurojë pajisje që plotësojnë në mënyrë maksimale kapacitetet funksionale dhe që ofrojnë performancën më optimale, me qëllim trajtimin me rezultate sa më të mira për sigurinë e qytetarëve. Në këto kushte, nga shqyrtimi i specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor për Kamera e Jashtme ANPR (Lexues Targe Makine), ky i fundit ka sqaruar se bazuar në nenin 36 të LPP-së, specifikimet teknike të mallrave që kërkohen të prokurohen janë përcaktuar qartësisht në shtojcën bashkëlidhur dokumenteve të tenderit. Gjithashtu, autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë ka cilësuar se kërkesat e ankimuesit për vendosjen e specifikimeve teknike të ndryshme nga ato të hartuara/vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk plotësojnë nevojat për mallra të këtij të fundit, si dhe ndryshojnë thelbin e procedurës së prokurimit, pasi është ai që ka fondet në dispozicion dhe vendos se çfarë i nevojitet.

Akoma më tej, në ankesën e tij, operatori ekonomik ankimues “Impact” SHPK nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete, që këto specifikime teknike çojnë drejt një prodhuesi të vetëm, apo kufizojnë në mënyrë të pajustificuar dhe të kundërligjshme konkurrencën. KPP rithekson se, fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht *sine qua non*, se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incumbit actor* (barra e provës i bie kërkuesit), si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “*në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Pra, operatori ekonomik ankimues duhet të

kishte argumentuar/dëshmuar, se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo se këto specifikime teknike nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtarë. Komisioni gjykon se, fakti që një ose disa prodhues nuk plotësojnë një apo disa specifikime teknike që lidhen ngushtësisht me funksionalitetin dhe performancën e pajisjes, nuk do të thotë që përbën automatikisht diskriminim ndaj këtyre prodhuesve.

Gjithashtu, lidhur me pretendimet për specifikimet teknike për pajisjen Kamera e Jashtme ANPR (Lexues Targe Makine), konkretisht për elementët si më poshtë vijon:

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Impact” SHPK, ankimuesi kërkon që të shtohet specifikimi teknik, konkretisht:

- “Tipi i kamerës (“Type of camera”)- Bullet/**Dome** PTZ RROTULLIM 360 Grade

III.9.1. Në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi në pikën 2.6. të specifikimit teknik përcaktohet si më poshtë:

- “Tipi i kamerës (“Type of camera”)- Bullet PTZ RROTULLIM 360 Grade

III.9.2. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimet sa më sipër sqarohet se: *“Në lidhje me pretendimin për ndryshimin e parametrave të kamerës së jashtme ANPR që propozohet prej ankimuesit, Bashkia Vlorë gjykon se jemi përpara specifikimeve të reja për mallra që mund të ndryshojnë vlerën, funksionalitetin apo nevojën e autoritetit kontraktor dhe nuk jemi përpara mallrave ekuivalentë. Sqarojmë se bazuar në nenin 36 të LPP-së, specifikimet teknike të mallrave që kërkohen të prokurohen janë përcaktuar qartësisht në shtojcën bashkëlidhur dokumentave të tenderit. Imponimi apo kërkesa e ankimuesit për vendosjen e specifikimeve teknike të ndryshme nga ato të hartuara/vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk plotësojnë nevojat për mallra të këtij të fundit, si dhe ndryshojnë thelbin e procedurës së prokurimit, pasi është ai që ka fondet në dispozicion dhe vendos se çfarë i nevojitet”.*

III.9.3. Referuar sa më sipër, KPP gjykon, se pretendimi i ankimuesit lidhur me shtimin e specifikimit teknik për pikën 2.6 Kamera e Jashtme ANPR (Lexues Targe Makine), konkretisht të tipit të kamerës DOME, nuk është e bazuar, pasi operatori ekonomik ankimues nuk ka argumentuar kërkesën e tij, në realizimin e plotë të funksionalitetit të pajisjes nëpërmjet produkteve të tjera të ngjashme ose ekuivalente me të tillë specifikim teknike (tipit të kamerës DOME) sipas ankimuesit, mund të realizohet pa u cenuar shërbimi që kërkon edhe autoriteti kontraktor në këtë procedurë prokurimi. Në këtë kuptim KPP gjykon, se në rastin konkret ankimuesi pretendon shtimin e specifikimit teknik, ndërkohë nuk shfaq ndonjë konfuzion lidhur

me specifikim ekzistues dhe për më tepër nuk argumenton cenimin që i vjen atij nga mungesa më e detajuar e tyre.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Impact” SHPK të parashtruara në ankesë, KPP gjykon se ky pretendim, në thelb, kanë të bëjnë me shtim të kriterëve të kualifikimit dhe jo me pretendime për modifikimin e kriterëve, diskriminuese, të cilët do të shkaktonin skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*. KPP gjykon, se që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar, duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve për kualifikim pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues, se procedurat për fitimin e kontratave publike, do t'i nënshtrohen kushteve specifike, të cilat duhet të përmbushin parakushtin e parashikuar nga neni 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Në rastin konkret, KPP gjykon, se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale, të gjykuara të nevojshme për vërtetimin e plotësisimit të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka parashikuar pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike, në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku në nenin 118 pika 2 gërma “b” të lex specialis parashikohet, se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kriteret kualifikimi ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin

ligjor në rast se kriteri i kualifikimit është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se kriteret e kualifikimit janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, pasi përcaktimi i kriterëve të kualifikimit, sipas kërkesës nga ankimuesi, konsiderohen kriteret e reja që do të rëndonin pozitën e operatorëve ekonomikë të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret të shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar të caktojë kriteret e kualifikimit në mënyrë eksplicite sipas propozimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.10. Ankimuesi kërkon që të ndryshohen (duke rritur/shtuar) vlerat e specifikimeve teknike, konkretisht:

- Ndricimi minimal (“Min Illumination”) - Color: **0.0008** lux
- Gjatësia fokale (“Focal length”) - **6-117** mm

III.10.1. Në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi në pikën 2.6. të specifikimit teknik përcaktohet si më poshtë:

- Ndricimi minimal (“Min Illumination”) - Color: 0.0005 lux
- Gjatësia fokale (“Focal length”)- 5-117mm

III.10.2. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimet sa më sipër sqarohet se: *“Në lidhje me pretendimin për ndryshimin e parametrave të kamerës së jashtme ANPR që propozohet prej ankimuesit, Bashkia Vlorë gjykon se jemi përpara specifikimeve të reja për mallra që mund të ndryshojnë vlerën, funksionalitetin apo nevojën e autoritetit kontraktor dhe nuk jemi përpara mallrave ekuivalentë. Sqarojmë se bazuar në nenin 36 të LPP-së, specifikimet teknike të mallrave që kërkohen të prokurohen janë përcaktuar qartësisht në shtojcën bashkëlidhur dokumenteve të tenderit. Imponimi apo kërkesa e ankimuesit për vendosjen e specifikimeve teknike të ndryshme nga ato të hartuara/vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk plotësojnë nevojat për mallra të këtij të fundit, si dhe ndryshojnë thelbin e procedurës së prokurimit, pasi është ai që ka fondet në dispozicion dhe vendos se çfarë i nevojitet”.*

III.10.3. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për hartimin e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike si dhe justifikimin për vendosjen e tyre, ka justifikuar kërkesën sa i takon ndriçimit minimal dhe gjatësisë fokale duke argumentuar, se nuk ka ndonjë standard kombëtar apo ndërkombëtar që përcakton vlerat minimum apo vlerat diapazon të tyre. Qëllimet e këtyre dy parametrave teknike janë: evidentimi minimal i ndriçimit si dhe diapazoni i gjatësisë fokale. Për sa kohë që vlerat minimum dhe vlerat diapazon të tyre të përcaktuara nga autoriteti kontraktor nuk cenojnë apo nuk janë diskriminues për ofertuesit pjesëmarrës, nuk ka arsye përse këto parametra teknike të vlerësohen duke rritur parametrat e tyre. Nga ana tjetër ankimuesi nuk provon se parametrat e kërkuar prej tij e bëjnë kamerën më funksionale dhe më cilësore sikundër pretendon apo akoma më tej parametrat e përcaktuar nga autoriteti kontraktor e kufizojnë ankimuesin në ndonjë aspekt për pjesëmarrje në procedurë apo ka ndonjë element diskriminues në të duke mos argumentuar pretendimin e tij.

Lidhur me pretendime e ankimuesit, KPP gjykon, se këto në thelb kanë të bëjë me rritje të specifikimeve teknike dhe jo me pretendime për modifikimin e tyre, diskriminues, të cilat do të shkaktonin skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*. KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e specifikimeve teknike pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurave për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike, të cilat duhet të përmbushin parakushtin të parashikuar nga neni 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Në rastin konkret, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriterin minimal, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësisë të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka parashikuar pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të

fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 118 pika 2 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik, janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kritere kualifikimi ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri i kualifikimit është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se kriteret e kualifikimit janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi rritjen e specifikimeve teknike në një procedurë prokurimi, pasi përcaktimi i tyre sipas kërkesës nga ankimuesi, konsiderohen të tilla që do të rëndonin pozitat e operatorëve ekonomik të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret të shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar të vendosë specifikimet teknike sipas propozimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të rrisë parametrat e specifikimeve teknike në një procedurë të prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.11. Ankimuesi kërkon që të ndryshohen (duke ulur) vlerat e specifikimeve teknike, konkretisht:

- Rezolucioni i figurës (“Resolution”) - **2592 X 1944**
- Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”) - minimumi 30 fps at **4 MP**

III.11.1. Në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi në pikën 2.6. të specifikimit teknik përcaktohet si më poshtë:

- Rezolucioni i figurës (“Resolution”) - **2560 X 1440**
- Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”) - minimumi 30 fps at **5 MP**

III.11.2. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimet sa më sipër sqarohet se: *“Në lidhje me pretendimin për ndryshimin e parametrave të kamerës së jashtme ANPR që propozohet prej ankimuesit, Bashkia Vlorë gjykon se jemi përpara specifikimeve të reja për mallra që mund të ndryshojnë vlerën, funksionalitetin apo nevojën e autoritetit kontraktor dhe nuk jemi përpara mallrave ekuivalente. Sqarojmë se bazuar në nenin 36 të LPP-së, specifikimet teknike të mallrave që kërkohen të prokurohen janë përcaktuar*

qartësisht në shtojcën bashkëlidhur dokumenteve të tenderit. Imponimi apo kërkesa e ankimuesit për vendosjen e specifikimeve teknike të ndryshme nga ato të hartuara/vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk plotësojnë nevojat për mallra të këtij të fundit, si dhe ndryshojnë thelbin e procedurës së prokurimit, pasi është ai që ka fondet në dispozicion dhe vendos se çfarë i nevojitet”.

III.11.3. Sa më sipër, KPP vëren, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në specifikimet teknike të sipërcituara rezolucionin e figurës dhe frekuencat e kuadrove. Ankimuesi kërkon uljen e këtyre parametri në frekuenca e kuadrove në min 30 fps at 4 MP dhe rezolucioni i figurës në 2594x1944. Autoriteti kontraktor argumenton se ka përcaktuar si kërkesë minimale frekuencën e kuadrove - minimumi 30 fps at 5 MP dhe Rezolucioni i figurës - 2560 X 1440, bazuar në nenin 36 të LPP-së, specifikimet teknike të mallrave që kërkohen të prokurohen janë përcaktuar qartësisht në shtojcën bashkëlidhur dokumenteve të tenderit. Lidhur me këtë argument, KPP gjykon se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për hartimin e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike njëherazi duhet të justifikojë nga pikëpamja funksionale dhe cilësore vendosjen e tyre. Në rastin konkret KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për frekuencën e kuadrove - minimumi 30 fps at 5 MP dhe Rezolucioni i figurës - 2560 X 1440, nuk janë argumentuar dhe nuk shpjegon teknikisht se përse një nivel më i ulët frekuence dhe rezolucioni cenon performancën dhe funksionalitetin e pajisjes. KPP gjykon, se është në të drejtën e autoritetit kontraktor të kërkojë mall me cilësi të lartë por në çdo rast autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë kufijtë maksimale të vendosur në ligj, duke mos tejkaluar ato dhe duke vendosur ato kërkesa që mundësojnë pjesëmarrje sa më të gjerë dhe hapje të konkurrencës. Në këto kushte KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimin e mësipërm duke rishikuar vlerën e vendosur në drejtim të uljes së saj me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe hapjen e konkurrencës në radhët e operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.12. Në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Sipas dokumenteve standarde të tenderit, në pikën 2.6. të specifikimit teknik

- Funksionalitete të tjera - Licensë Plate Recognition, Plate Type Classification, Plate Color Recognition, Vehicle Type Classification, Vehicle Color Recognition, Vehicle Direction Detection (minimum 4 regions).

III.12.1. Ankimuesi kërkon që të ndryshohen (duke hequr) vlerat e specifikimeve teknike, konkretisht

- Funksionalitete të tjera - Licensë Plate Recognition, Vehicle Color Recognition.

III.12.2. Referuar shkresës nr. 6894/2 prot., datë 24.06.2022, autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë ka sqaruar ankimuesin se në shtojcën nr. 5 të dokumenteve standarde të tenderit përcaktohet

shprehimisht se: *“Referuar udhëzimeve të APP, për zërat në DST që mund të jetë paraqitur markë/brand, operatorë ekonomikë mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike”*.

III.12.3. Sa më sipër, KPP vëren, se autoriteti kontraktor ka cituar, se funksionalitetet e tjera të kamerës përfshirë licencat është një komponent i rëndësishëm i kamerës së jashtme ANPR, pasi ofron një mall me një cilësi më të mirë. Funksionalitetet e tjera, referuar shkresës së autoritetit kontraktor, janë kërkuar me lloje licencash të tilla, në mënyrë që të ofrojë mundësinë për mall me cilësor bazuar në nenin 36 të LPP-së, ku specifikimet teknike të mallrave që kërkohen të prokurohen janë përcaktuar qartësisht në shtojcën bashkëlidhur dokumenteve të tenderit. Lidhur me këtë argument, KPP gjykon se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për hartimin e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike njëherazi duhet të justifikojë nga pikëpamja funksionale dhe cilësore vendosjen e tyre. Në rastin konkret KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për Licence Plate Recognition, Plate Type Classification, Plate Color Recognition, Vehicle Type Classification, Vehicle Color Recognition, Vehicle Direction Detection (minimum 4 regions) nuk është e argumentuar dhe nuk shpjegon se përse funksionalitete të tjera të kamerës me nivele më të ulët në licencë cenon performancën dhe funksionalitetin e pajisjes. KPP gjykon se është në të drejtën e autoritetit kontraktor të kërkojë mall me cilësi të lartë, por në çdo rast autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë kufijtë maksimale të vendosur në ligj duke mos tejkaluar ato dhe duke vendosur ato kërkesa që mundësojnë pjesëmarrje sa më të gjerë dhe hapje të konkurrencës. Në këto kushte KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimin e mësipërm duke rishikuar llojet e licencave të kërkuara. Gjithashtu, edhe për sa i takon licencave të kërkuara KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të shtojë frazën ekuivalent me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në radhët e operatorëve ekonomikë.

Akoma më tej, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, se operatorët ekonomikë të interesuar kanë mundësinë të paraqesin edhe certifikata ekuivalente. Gjithsesi, për ta bërë më të qartë ekuivalencën e kualifikimeve, si dhe për të hapur sa më shumë konkurrencën dhe gamën e zgjidhjeve të propozuara, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë kriteret e mësipërme duke përcaktuar certifikatat që duhen për të vërtetuar aftësitë e shoqërisë bazuar në funksionin dhe nivelin e ekspertizës që duhet të zotërojë. Në rastet kur, bazuar në terma funksionalë, është e pamundur që të hartohet në mënyrë të qartë kriteri i kualifikimit, autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata konkrete, por me kushtin që krahas termit ekuivalent duhet të shtojë gamën e shembujve ekuivalent.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti

kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të vendosë ato specifikime teknike për pajisjet objekt-prokurimi të cilat nuk bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor, si organi përgjegjës për zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe hartimit të kritereve të kualifikimit, duhet të modifikojë këto specifikime teknike, në përputhje me konstatimet e sipërcituara, në këtë procedurë prokurimi, për sa kohë që nuk cenon mirëfunksionimin e pajisjes, cilësinë dhe kohën e ekzekutimit të punës së pajisjes që do të prokurohet.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Impact” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-32392-06-09-2022, me objekt “Sistemi i monitorimit me kamera të qytetit” me fond limit 8,214,311 (tetë milionë e dyqind e katërbëdhjetë mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 20.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Impact” SHPK

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro